Republika e Kosovës
Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit
Institucija Ombudsmana • Ombudsperson Institution
Nr./Br./No. 959/2016
Nr.i fo/Br.str./No pg.
Data/Datum/Date 06/09/16
PRISHTINË/PRIŠTINA-PRISTINA

Opinion i Avokatit të Popullit

në lidhje me procedurat e ankimimit të vendimeve administrative lidhur me çështjen e njohjes dhe verifikimit të statusit të veteranit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

drejtuar

Qeverisë së Republikës së Kosovës

Prishtinë, më 6 shtator 2016

Rr./Ul./ Migjeni, nr./br. 21 • 10000 • Prishtinë/Priština • Kosovë/Kosovo
Tel: +381 (0) 38 223 782, 223 783, 223 784 • Fax: +381 (0) 38 223 790
www.ombudspersonkosovo.org • info@ombudspersonkosovo.org

BAZA LIGJORE

Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 135 (3):"*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore".*

Ligji Nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 18 (3): *"Avokati i Popullit mund të këshillojë dhe t'u rekomandojë autoriteteve të Qeverisë së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në territorin e Republikës së Kosovës".*

QËLLIMI

1. Duke marrë parasysh Vendimin nr. 05/90, të datës 1 qershor 2016, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, si dhe duke pasur parasysh rëndësinë e aplikueshmërisë së ligjeve në fuqi, me theks të veçantë mbi respektimin e procedurës së rregullimit të statusit të veteranit të luftës, ky opinion i Avokatit të Popullit ka për qëllim që:

   - Të tërheq vëmendjen Qeverisë së Republikës së Kosovës se Vendimi 05/90, i datës 1 qershor 2016, nuk është në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe, në këtë mënyrë, shkel të drejtat e procedurës së rregullimit të statusit të veteranit të luftës;

   - Të propozojë procedurën ankimore më të përshtatshme për palët e interesuara në rregullimin e statusit të veteranit të luftës, kundër vendimit të nxjerrë nga ana e organit të administratës publike, konkretisht Komisionit Qeveritar për Njohjen dhe Verifikimin të Statusit të Dëshmorit të Kombit, Invalidit, Veteranit, Pjesëtarit apo të Internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (këtu e tutje Komisioni).

BAZA LIGJORE E VEPRIMIT TË AVOKATIT TË POPULLIT

2. Në pajtim me nenin 135 (3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, *"Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore".* Më tutje, *Lex specialis* mbi punën e Avokatit të Popullit, konkretisht Ligji Nr.05/L-019 (këtu e tutje Ligji për Avokatin e Popullit), parasheh në nenin 18 (3) që është nën përgjegjësinë e të njëjtit të :*"këshillojë dhe t'u rekomandojë autoriteteve të Qeverisë së Kosovës për programet dhe politikat e tyre për të siguruar mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në territorin e Republikës së Kosovës",* dhe 18 1.6 *"t'i publikojë njoftimet, mendimet, rekomandimet, propozimet dhe raportet e veta."*

GJENDJA FAKTIKE

3. Në prill të vitit 2014 Kuvendi i Kosovës ka miratuar Ligjin Nr.04/L-261 për Veteranët e Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (këtu e tutje Ligji për Veteranët) i cili parasheh beneficione për veteranë, duke përfshirë e duke mos u kufizuar me: pension, shërbime shëndetësore falas, të drejtën e përparësisë në punësim, drejtën e udhëtimit falas, përkujdesja për banim, stazhi i dyfishtë si dhe përparësia e pranimit në institucionet arsimore publike.

4. Në lidhje me atë që u tha më lart, Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (këtu e tutje Organizata e Veteranëve) ka kërkuar[1] nga Qeveria e Republikës së Kosovës që ta zbatojë këtë Ligj, duke konsideruar që pas miratimit të të njëjtit, pozita shoqërore dhe ekonomike e veteranëve do duhej të përmirësohej dukshëm.

5. Ligji për Veteranët parasheh Komisionin Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të veteranëve, i cili është themeluar në bazë të Ligjit 04/L-054 për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, viktimave civile dhe familjeve të tyre (këtu e tutje Ligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile dhe familjeve të tyre). Ky Komision ka për mandat njohjen e statusit të veteranit dhe kategorive të tjera. Puna e këtij Komisioni është e rregulluar me Rregulloren Nr.23/2012 për Komisionin Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit, veteranit, pjesëtarit apo të internuarit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (këtu e tutje Rregullore për Komisionin).

6. Më tutje, Kryesia e Organizatës së Veteranëve, në një nga mbledhjet e saj[2], ka shqyrtuar edhe çështjen e verifikimit të veteranëve të luftës dhe ka ardhur në përfundim që ka numër të fryrë të veteranëve, si dhe nga ata të cilëve iu është dhënë statusi i veteranit pa bazë, gjë kjo e cila është në kundërshtim me ligjin në fuqi. Në atë drejtim, kjo Organizatë i ka bërë thirrje Prokurorisë së Shtetit, që të bëjë vërtetimin e numrit të saktë të veteranëve.

7. Në lidhje me atë që u theksua më lart, Prokuroria e Shtetit ka dhënë deklaratë[3] në bazë të së cilës konkludohet se një çështje e tillë nuk bie në domenin e punës së Prokurorisë së Shtetit, përderisa e njëjta mund të jetë përgjegjëse dhe kompetente vetëm për ndjekjen e personave të dyshuar për kryerjen e veprave penale, si dhe do të kryejë hetime në secilin rast ku ka dyshim të bazuar që është kryer një vepër penale e ku plotësohen kushtet e parapara me ligj.

[1] Portali koha.net: "Veteranët falënderojnë deputetët për Ligjin", i datës 3 prill 2014.
[2] Portali koha.net: "OVL-UÇK-së: Numri i veteranëve i fryrë, Prokuroria t'i nis hetimet", i datës 8 qershor 2016.
[3] Portali koha.net: "Prokuroria e Shtetit: Nuk merremi me pastrim listash të veteranëve, por me hetime", i datës 28 qershor 2016.

8. Po ashtu, në lidhje me këtë çështje, është deklaruar[4] edhe Fondi Monetar Ndërkombëtar (këtu e tutje FMN) I cili ka paralajmëruar Qeverinë e Republikës së Kosovës se vë në rrezik buxhetin e shtetit, me ndarjen e parave për veteranë. Sipas FMN-së, edhe pse janë ndarë 60 milion euro, Qeveria rrezikon të përfshihet në një shpenzim prej 100 milion euro, për të zbatuar obligimet ndaj veteranëve, të përcaktuara me ligj. FMN konsideron që një shpenzim i këtillë i buxhetit nuk duhet bërë ndaj çështjeve jo emergjente.

9. Në fund, por jo edhe nga rëndësia, Qeveria e Republikës së Kosovës, me 1 qershor të vitit 2016, ka nxjerrë Vendimin Nr.05/90, me anë të së cilit ka aprovuar Raportin e Komisionit. Sipas këtij Vendimi, evidenca e prezantuar nga Komisioni në Raportin nga pika 1: "*miratohet si listë e pa përmbyllur e verifikimit të personave të kategorizuar sipas Ligjit për Veteranë*" dhe se lista përfundimtare mbetet të shqyrtohet dhe miratohet në të ardhmen, gjë, kjo, e cila u kundërvihet dispozitave ligjore në fuqi.

KORNIZA LIGJORE

10. Ligji Nr.04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre (Ligji për Statusin e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të UÇK-së, Viktimave Civile dhe familjeve të tyre) me anë të të cilit rregullohet statusi që përfshin, por nuk kufizohet me veteranë. Po ashtu, fushëveprimi i këtij Ligji shtrihet mbi rregullimin e të drejtave dhe beneficioneve të posaçme për anëtarët e familjeve të veteranëve, si dhe procedurat administrative për realizimin e këtyre të drejtave.

11. Neni 6 i Ligjit të lartpërmendur, taksativisht, numëron beneficionet që u takojnë kategorive të përcaktuara me këtë ligj, "*varësisht nga statusi dhe kriteret e përcaktuara, për shkak të sakrificës sublime dhe kontributit shumë të lartë në luftën çlirimtare të UÇK-së*". Neni në fjalë, përfshin, por nuk kufizon: shtesa për përkujdesje, rehabilitim mjekësor, shërbimet spitalore jashtë vendit pa kompensim, stazhin e dyfishtë, lirimin nga tatimi në pronë, përparësinë e regjistrimit dhe pranimit në institucione arsimore publike si dhe tarifën e liruar dhe reduktimi i harxhimeve të energjisë elektrike për nevoja personale.

12. Neni 12, që rregullon statusin dhe të drejtat e veteranëve të UÇK-së, përcakton se: "*sipas dispozitave të këtij ligji, nga organi përgjegjës i Qeverisë, njihet dhe përcaktohet statusi i veteranëve të UÇK-së*" dhe "*Të drejtat në beneficione për veteranët e UÇK-së si dhe kriteret e kualifikimit për njohjen dhe realizimin e tyre do të rregullohen me ligj të veçantë*".

13. Neni 15(1) i këtij Ligji rregullon njohjen dhe statusin, duke paraparë si kompetente për këtë çështje: "Komisionin Qeveritar për njohjen dhe verifikimin e statusit të dëshmorit të kombit, invalidit të UÇK-së, veteranit, pjesëtarit të UÇK-së apo të

[4] Portali telegrafi.com: "FMN kritikon ashpër Qeverinë: Për veteranët po e rrezikoni buxhetin", qershor 2016.

internuarit të UÇK-së". Më tutje, në paragrafin 8 të po të njëjtit nen, përcaktohet: "*Organizimi i punës, funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë, pagesa për angazhimet e anëtarëve, si dhe çështjet tjera të rëndësishme të Komisionit Qeveritar, do të përcaktohen me akt nënligjor të nxjerrë nga Qeveria e Kosovës*". Në fund, paragrafi 9 i këtij neni, përcakton që: "*Komisioni Qeveritar...()..përcakton Listën e personave të kategorive të përcaktuara me këtë ligj*".

14. Më tutje, neni 19 i këtij Ligji parasheh: "*...drejtpërsëdrejti do të zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative*".

15. Në fund, neni 20 i po të njëjtit Ligj parasheh obligimin e Qeverisë që të nxjerr: "*rregulloren për fushëveprimin dhe funksionimin e Komisionit Qeveritar për njohjen dhe përcaktimin e statusit të kategorive të dala nga lufta e UÇK-së*".

16. Ligji Nr.04/L-261 për Veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (Ligji për Veteranë) në nenin 2, rregullon fushëveprimin e këtij Ligji, duke përcaktuar se: "*me këtë ligj përcaktohen të drejtat në beneficione për Veteranët e UÇK-së dhe anëtarët e ngushtë të familjeve të tyre, kriteret e kualifikimit për njohjen dhe realizimin e tyre si dhe procedurat administrative për realizimin e këtyre të drejtave, siç është përcaktuar në nenin 12 paragrafi 2, të Ligjit për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile dhe familjeve të tyre*".

17. Neni 5 i këtij Ligji përcakton që: "*Statusi i të gjitha kategorive të veteranëve të UÇK-së konstatohet nga Komisioni*".

18. Më tutje, neni 6, në paragrafin 2, rregullon publikimin e listave fillestare, duke përcaktuar që: "*Komisioni bën publike Listat fillestare sipas kategorive përkatëse*". Listat fillestare mbesin publike tridhjetë (30) ditë, sipas paragrafit të tretë të këtij neni. "*Personat të cilët për arsye të caktuara nuk kanë pasur mundësi për aplikim për njohjen e statusit të veteranit mund të aplikojnë për njohjen e këtij statusi në bazë të kritereve të përcaktuara me akt nënligjor të veçantë*", në bazë të paragrafit 4 të nenit 6.

19. Për më tepër, neni 7 i këtij Ligji, rregullon procedurën ankimore, duke paraparë afatin kohor prej tridhjetë (30) ditësh nga shpallja publike e Listave fillestare, brenda të cilit "çdo aplikues me prova të reja apo i cili mendon se i është bërë e padrejtë, mund t'i drejtohet Komisionit për rishqyrtimin e ankesës". I njëjti afat është i aplikueshëm edhe për: "*çdo qytetar i cili ka të drejtë të paraqesë ankesë apo fakte lidhur me personat që janë apo që nuk duhet të jenë në Listën fillestare të kategorive të dala nga Lufta e UÇK-së*", në bazë të paragrafit të dytë të këtij neni. Në fund, paragrafi 5 i këtij neni parasheh që: "*Kundër vendimit të Komisionit pala e pakënaqur ka të drejtë që të inicojë procedurën në Gjykatën kompetente*".

20. Neni 36 i këtij Ligji parasheh aplikueshmërinë e dispozitave të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

21. Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (këtu e tutje Ligji për Procedurën Administrative) rregullon realizimin efektiv të autoritetit publik në shërbim të interesit publik, duke gjetur zbatim në çdo rast kur një organ publik realizon autoritetin publik, konkretisht (neni 2): *"vendos për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave..."*.

22. Në bazë të nenit 52 (1.5.) të këtij Ligji për Procedurën Administrative, një akt administrativ është i paligjshëm, kur: *"është në kundërshtim me ligjin material"*.

23. Në lidhje me paragrafin më lart, neni 57 i këtij Ligji për Procedurën Administrative parasheh shfuqizimin e një akti administrativ të ligjshëm: *"për shkak të ndryshimit të situatës apo rrethanave faktike ose ligjore apo për shkak të arsyeve tjera të parapara me ligj."*

24. Në fund, por jo edhe nga rëndësia, neni 98 i këtij Ligji për Procedurën Administrative, parasheh afatin për përfundimin e procedurës administrative, duke theksuar në paragrafin 2, që: *"në rast së ligji i veçantë nuk ka paraparë një afat, siç është paraparë në paragrafin 1 të këtij neni, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj"*, që është në lidhje me nenin 131 i cili parasheh procedurën e shqyrtimit të ankesës nga organi kompetent publik, ku sipas paragrafit 4: *"kur organi publik kompetent vlerëson se ankesa është e pranueshme dhe e bazuar plotësisht, me një akt të rri administrativ do të anulojë apo ndryshojë aktin e ankimuar, gjegjësisht do të lëshojë aktin e refuzuar, siç është kërkuar nga pala"*.

25. Bazuar në nenin 144 të këtij Ligji, një akt administrative do të bëhet i ekzekutueshëm me: *"skadimin e afatit për ankesën kundër tij, nëse një ankesë e tillë nuk është parashtruar."*

26. Gjykata kompetente vendos mbi ligjshmërinë e akteve administrative, me të cilat organet kompetente të administratës publike vendosin për të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizik dhe juridik, në bazë të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative (këtu e tutje Ligji për Konfliktet Administrative).

27. Përderisa neni 13 i këtij Ligji për Konfliktet Administrative përcakton që: *"konflikti administrative mund të fillojë vetëm kundër aktit administrative të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë"*, neni 16 parasheh mundësinë që akti administrativ të kundërshtohet: *"për shkak se nuk janë aplikuar fare ose nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore."*

28. Në bazë të nenit 18: *"paditës në konfliktin adminsitrativ mund të jetë personi fizik, juridik, Avokati i Popullit dhe shoqatat e organizatat tjera që veprojnë në mbrojtje të interesit publik"*, kurse në bazë të nenit 19: *"atëherë kur personi fizik është anëtar i ndonjë organizate joqeveritare, ()kjo organizatë mundet ()në emër të tij ta paraqesë padinë dhe të zhvillojë konfliktin administrative kundër aktit administrativ"*.

29. Më tutje, Rregullorja për Komisionin Qeveritar me nenin 9 rregullon procedurën e ankesës, duke përcjellë këtu fjalën e ligjit dhe duke caktuar mundësinë e paraqitjes së ankesës: *"një muaj pasi Regjistrat bëhen publike"*. Për më tepër, rishqyrtimin bën Komisioni i Posaçëm prej tre anëtarësh të Komisionit, të emëruar nga Komisioni, bazuar në paragrafin 4 të këtij neni.

30. Neni 10 i Rregullores për Komisionin Qeveritar parasheh përcaktimin e regjistrave përfundimtarë: *"një muaj pasi Regjistrat bëhen publike"*.

31. Vendimi Nr.05/90 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, i datës 1 qershor 2016, aprovon raportin e Komisionit Qeveritar dhe miraton evidencën e prezantuar nga Komisioni si: *"të pa përmbyllur, në lidhje me verifikimin e personave të kategorizuar në bazë të Ligjit 04/L-261 për veteranët e luftës së UÇK-së"*. Për më tepër: *"lista përfundimtare () mbetet të shqyrtohet dhe miratohet në të ardhmen"*.

ANALIZA LIGJORE

32. Ligji për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile dhe familjeve të tyre parasheh beneficionet që do t'i takojnë këtyre kategorive, duke paraparë krijimin e Komisionit Qeveritar kompetencat e të cilit do të pasqyroheshin në përcaktimin e statusit të njërës prej kategorive të përmendura më lart. Në pajtim me nenin 15 të këtij Ligji përcaktohet përbërja e këtij Komisioni Qeveritar, ku, në paragrafin 8, parashihet organizimi i punës së këtij Komisioni Qeveritar me akt nënligjor.

33. Më tutje, Ligji i veçantë për Veteranët, rregullon të drejtat në beneficione të kategorisë specifike, veteranëve të UÇK-së, duke iu referuar ndërmjet tjerash: shtesës në përkujdesje, shërbimit shëndetësor pa pagesë jashtë vendit dhe stazhit të dyfishtë. I njëjti Ligj i referohet punës së Komisionit Qeveritar të paraparë me Ligjin për statusin dhe të drejtat e dëshmorëve, invalidëve, veteranëve, pjesëtarëve të UÇK-së, viktimave civile dhe familjarëve të tyre. Mund të konkludohet përtej çdo dyshimi që Komisioni Qeveritar është kompetent në përcaktimin e statusit të veteranit të luftës dhe që i njëjti do të veprojë në bazë të aktit nënligjor të nxjerrë nga ana e Qeverisë së Kosovës. Konstatimi i statusit të veteranit nga ana e këtij Komisioni Qeveritar, do t'ia mundësojë përfituesit të këtij statusi shfrytëzimin e beneficioneve të parapara me dy ligje të lartpërmendura, e në bazë të sakrificës, angazhimit dhe kontributit të çmuar në Luftën Çlirimtare të Kosovës.

34. Në bazë të asaj që u tha më lart, Komisioni Qeveritar vepron si vijon: publikon listat fillestare dhe lejon afatin prej tridhjetë (30) ditësh gjatë së cilit çdo aplikues ka të drejtë ankimi në bazë të provave të reja, apo i cili mendon se i është bërë një e padrejtë, e kjo në bazë të nenit 7 të Ligjit për Veteranë. Në lidhje me këtë, e në bazë të paragrafit 2 të po të njëjtit nen, çdo qytetar ka të drejtë të paraqes ankesë apo fakte lidhur me personat që janë apo nuk duhet të jenë në Listën fillestare, brenda afatit të paraparë prej tridhjetë (30) ditësh.

35. Komisioni Qeveritar, në bazë të Rregullores mbi Komisionin Qeveritar përcakton procedurën ankimore. Kjo Rregullore parasheh afatin prej tridhjetë (30) ditësh brenda të cilit mund të ankohet pala e kënaqur dhe mbi ankesën e së cilës vendos Komisioni i Posaçëm për rishqyrtimin e kërkesës, i përbërë nga tre anëtarë të Komisionit, të emëruar nga Komisioni. Përderisa afati për ushtrimin e ankesës është përcaktuar, Ligji por edhe Rregullorja heshtin kur flitet për afatin kohor brenda së cilit duhet të merret vendimi mbi ankesën e ushtruar. Megjithatë, Ligji për Veteranët, në nenin 36, shprehimisht iu referohet dispozitave të Ligjit për Procedurën Administrative, që do të aplikohen, në qoftë se nuk është përcaktuar ndryshe me dispozita ligjore Në lidhje me këtë, e në bazë të nenit 98 të Ligjit për Procedurën Administrative, në rast se ligji i veçantë nuk ka paraparë afat për përfundimin e procedurës, siç është rasti me Ligjin për Veteranët, afati i përgjithshëm i zbatueshëm për përfundimin e procedurës administrative është dyzetepesë (45) ditë nga fillimi i saj. Duke marrë parasysh faktin që neni 98 i referohet përfundimit të procedurës administrative, duke nënkuptuar nxjerrjen e vendimit në shkallë të parë, mund të konkludohet që i njëjti rregull vlen edhe për përfundimin e procedurës pas ankesës, pasi që: 1) edhe neni 98 parasheh përfundimin e procedurës sa më shpejtë që është e mundur, pasi që një parim i tillë është në proporcionalitet me mbrojtjen e të drejtave të palëve në procedurë dhe parandalimin e zvarritjes së procedurës dhe 2) kapitulli i Ligjit për Procedurën Administrative, i cili rregullon procedurën ankimore, nuk parasheh rregulla të veçanta mbi afate për përfundimin e procedurës. Në lidhje me këtë që u tha deri tani, mund të vihet në përfundim që Komisioni i Posaçëm për rishqyrtim të ankesave, duhet të nxjerrë listën përfundimtare mbi statusin e veteranëve, brenda periudhës së paraparë me Ligjin për Procedurën Administrative.

36. Duke përcjellë dispozitat e Ligjit për Procedurën Administrative mbi afatet, mund të krijohet përshtypja që dispozitat e nenit 78 janë të aplikueshme në rastin e vendosjes mbi ankesë të Komisionit të Posaçëm për rishqyrtim të ankesave. Paragrafi 2 i këtij neni thekson që: *"në qoftë se ligji apo akti nënligjor nuk precizojnë një afat të caktuar, afati përcaktohet nga vetë organi publik që kryen procedurën në përputhje me nenin 10"*, nen, i cili, në paragrafin e dytë thekson se: *"organi publik zhvillon procedurën administrative sa më të shpejtë dhe me sa më pak shpenzime, për të dhe për palën, duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative"*. Marrë këtë parasysh, lind nevoja të iu referohet përsëri dispozitave të nenit 98, që rregullon afatet për përfundimin e procedurës siç është shpjeguar në nenin më lart. Duke mos paragjykuar dispozitat e nenit 78, duhet të merret parasysh që neni 98 iu referohet afateve mbi përfundimin e procedurës: *"të inicuar me kërkesë të palës"*. Ushtrimi i ankesës mbi aktin administrativ të nxjerrë nga organi i administratës, mund të konsiderohet kërkesë e përsëritur e palës, përmes së cilës *ri-kërkohet* njohja apo mos njohja e status të veteranit. Atëherë, duhet të konstatohet që dispozitat e aplikueshme në lidhje me afatet mbi përfundimin e procedurës administrative pas ushtrimit të ankesës, janë dispozitat e nenit 98.

37. Duke mos paragjykuar atë që u tha më lart, Rregullorja për Komisionin Qeveritar parasheh të drejtën e ankimimit në Gjykatën kompetente, kundër Vendimit të Komisionit të Posaçëm. Bazuar në Ligjin për Konfliktet Administrative, qëllimi i të njëjtit është mbrojtja gjyqësore e të drejtave të personave fizik dhe juridik, interesa këto që janë cenuar me vendime individuale ose me veprimet e organeve të administratës publike. Për më tepër, ky Ligj në nenin 13 parasheh fillimin e konfliktit administrativ kundër aktit administrativ të nxjerrë në procedurën administrative në shkallë të dytë dhe në nenin 16 parasheh kundërshtimin e të njëjtit, për shkak se nuk janë aplikuar fare ose nuk janë aplikuar drejt dispozitat ligjore. Për më tepër, ky Ligj parasheh në rolin e paditësit personin fizik, juridik, por edhe Avokatin e Popullit, duke mos përjashtuar edhe organizatën joqeveritare, brenda së cilës personi fizik është anëtar dhe në interesin e të cilit organizata mund të veprojë, siç do mund të ishte rasti me Organizatën e Veteranëve të luftës së UÇK-së. Duke pasur parasysh këtë e duke mos anashkaluar faktin që caktimi i statusit të veteranit kalon nëpër procedurë administrative me vendim të nxjerrë nga organi i administratës publike, përmes ligjeve të cilat parashohin aplikueshmërinë e dispozitave të Ligjit mbi Procedurën Administrative, e përmes punës së Komisionit që nxjerr vendim në formë të aktit administrativ që mund të goditet përmes procedurës para gjykatës, konkretisht konfliktit administrativ, mund të thuhet përtej çdo dyshimi që kjo është procedura e duhur për t'u përcjellë nga pala e pakënaqur e interesuar për njohjen e statusit të veteranit të luftës. Kjo edhe për arsye të mundësisë së kundërshtimit të aktit përfundimtar për shkak të mos aplikimit apo aplikimit jo të drejtë të dispozitave ligjore dhe për faktin që konflikti administrative shërben *apriori* për mbrojtjen e interesave që janë cenuar me vendime individuale apo me veprime **të organeve të administratës publike.**

38. Nisur nga ajo që u tha më lart, këndvështrim i veçantë duhet të vihet mbi Vendimin 05/90 të nxjerrë nga ana e Qeverisë së Kosovës, me 1 qershor 2016, përmes së cilit miratohet evidenca e prezantuar nga Komisioni dhe lista si e pa përmbyllur. Më tutje, i njëjti Vendim, parasheh shqyrtimin dhe miratimin e Listës përfundimtare në të ardhmen. Ky Vendim nuk parasheh dhe nuk përmend afatin tridhjetë (30) ditësh për ushtrimin e ankesës kundër listës iniciale të publikuar. Lista e miratuar në këtë mënyrë, si e *"pa përmbyllur"* dhe e cila nuk evidenton afatin kohor për ankesë, nxit pasiguri juridike, duke mos garantuar statusin e veteranëve të evidentuar në listë, posaçërisht, duke mos paraparë respektimin e hapave ligjorë që i referohen procesit të ankesës dhe afatit për ushtrimin e të njëjtës. E njëjta vlen edhe për *"miratimin e listës përfundimtare në të ardhmen"*, e ardhme, kjo, e cila nuk përcaktohet me një afat kohor që automatikisht nxit pasiguri juridike dhe mos respektimin e dispozitave ligjore të përcaktuara në Ligjin për Procedurën Administrative, në lidhje me afatet kohore, por edhe në lidhje me parimet e përgjithshme të procedurës, sipas të cilave: *"organi publik duhet zhvilluar procedurë sa më të shpejtë () duke mos cenuar çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm e të përshtatshëm të procedurës administrative"*.

Në bazë të asaj që u tha më lart, Avokati i Popullit, në përputhje me nenin 135, par. 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenin 18, par. 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, nxjerr këtë:

OPINION

Është e nevojshme që Qeveria e Republikës së Kosovës është e nevojshme ta rishikojë punën e Komisionit Qeveritar sa i përket dispozitave ligjore përkitazi me respektimin e afateve kohore për ushtrimin e ankesës, publikimin e listave fillestare, por edhe në lidhje me afatet për përfundimin e procedurës administrative pas ankesës, në bazë të analizës së dispozitave ligjore të Ligjit për Procedurën Administrative të përshkruar më lart.

Avokati i Popullit e vlerëson të nevojshëm ndryshimin e Rregullores mbi Komisionin Qeveritar sa i përket dispozitave që përcaktojnë afatet kohore për nxjerrjen e vendimeve të Komisionit Qeveritar pas ankesës dhe përcaktimit shprehimor të natyrës së vendimeve të Komisionit të Posaçëm për rishqyrtim të ankesave (vendosja përmes aktit përfundimtar administrativ), po ashtu edhe

Ndryshimin e Rregullores mbi Komisionin Qeveritar në aspekt të përbërjes së Komisionit të Posaçëm për rishqyrtim të ankesave, pasi që aktualisht, anëtarët përzgjidhen nga radhët e anëtarëve të Komisionit Qeveritar, që kanë marrë vendimin në shkallë të parë. Me qëllim të sigurimit të pavarësisë në nxjerrjen e vendimeve, sidomos në rregullimin e çështjeve të ndejshme, siç është kjo e rregullimit të statusit të veteranit të luftës, që me vete sjell gëzimin e beneficioneve të përcaktuara me ligj, duhet vepruar në drejtim të ndryshimit të Rregullores mbi Komisionin Qeveritar, në pajtim me përshkrimin e dhënë.

Me nderime,

Hilmi Jashari
Avokat i Popullit